



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:117381
Datë: 03.12.2024
Numri i dokumentit: 06542934

K.DH.SH.II.1322/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar kolegji, Ramush Bardiqi dhe Dren Rogova, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit NNSH Agimi Komerce me seli në Mitrovicë të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shefqet Ibrahimimi avokat në Skënderaj, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve nga Prishtina, të cilën e përfaqëson me autorizim A. I., për shkak të kompensimit të dëmit-fitim i humbur, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurit të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.113/22 të datës 24.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.113/22 i datës 24.05.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar KE.nr.113/22 i datës 24.05.2024, dhoma e shkallës së parë, ka vendosur si ne vijim: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NNSH Agimi Komerce, dhe Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit – fitimit të humbur për periudhën e pamundësisë së përdorimit të automjetit “mercedes” tipi 905 me tabela 631-KS-944, për 22 ditë pune, t,ia paguaj paditësit

shumën prej 2,002.40Euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 23.03.2016 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi, II. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit NNSH Agimi Komerce, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Byroja Kosovare e Sigurimeve, që në emër të kompensimit të dëmit-fitimi i humbur për periudhën e pamundësisë së përdorimit të automjetit “mercedes” tipi 905 me tabela 631-KS-944, nga data 02.04.2015 deri datën 20.01.2016, t,ia paguaj paditësit shumën prej 18,772.50€, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë datë 23.03.2016 e deri në pagesën definitive, III. Detyrohet e paditura që paditësit t,ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,482.20Euro, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar, të priset ose të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Në përgjigje ne ankesë i autorizuari i paditësit deklaron se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe propozon që të aprovohet pjesërisht ankesa e të paditurit të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet ne rigjykim

Dhoma e Shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi NNSH Agimi Komerce me seli në Mitrovicë, me datën 23.03.2016 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve nga Prishtina, për kompensimin e dëmit, nga dëmi i shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit datës 01.04.2015. Në padi dhe në seancat gjyqësore përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se në aksidentin e ndodhur me automjetin e vet transportues me tabela 631-KS-944, ishte goditur nga automjeti i udhëtarëve me tabela regjistrimit KM-010-CC pa policë sigurimit dhe i paregjistruar, të cilin ka qenë duke e drejtuar V. R.,. Paditësi për dëmin material është kompensuar nga i padituri në automjetin transportues, mirëpo nuk i është kompensuar fitimi i humbur. Nga provat e administruara është vërtetuar në tërsi gjendja faktike,

se është vërtetuar baza e kërkesëpadisë në lartësi prej 20,774.90€ në emër të fitimit të humbur së bashku me kamatën ligjore 8%. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj kërkesëpadinë dhe të obligoj të paditurin që të paguaj shumën prej 20,774.90€ me kamatë ligjore 8% dhe shpenzimet procedurale.

I padituri në përgjigje në padi dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar kundërshton kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe nga lartësia pasi që nuk vërtetohet baza e kërkesëpadisë për pranimin e përgjegjësisë për dëmshpërblim nga ana e paditurit. Bazuar në nenin 4 të Ujdisë jashtëgjyqësore, paditësi ka hequr dorë nga e drejta për kompensim shtesë material, i propozon gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar sepse nuk provohet se paditësi ka pësuar dëm material në formën e fitimit të humbur.

Dhoma e shkallës së parë duke vepruar në rigjykim, pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor datës 16.05.2024, ka nxjerr aktgjykimin e atakuar me të cilin ka Aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata thekson se pas vlerësimit të gjendjes faktike, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar për faktin se paditësi si pasojë e mungesë së automjetit të tij transportues, për 22 ditë pune ose një muaj kalendarik mestar të vitit, paditësit i është shkaktuar dëm në lartësi prej 2,002.40€, siç është përcaktuar për numrin e ditëve të nevojshme për riparimin e automjetit transportues e ekspertizën e makinerisë të hartuar nga eksperti S. B., dt.20.01.2020 dhe me ekspertizën financiare dt.03.12.2018, me të cilat konstatohet se për kohën e nevojshme për riparimin e automjetit transportues, paditësi ka pësuar dëm në formën e fitimit të humbur shumën e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar në dispozitën I të këtij aktgjykimi, pasi që servisimi i automjetit ka zgjatur nga ata 02.04.2015 deri 20.01.2016, mirëpo sipas ekspertizës së makinerisë, koha e arsyeshme për riparimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti ka qenë 22 ditë apo përafërsisht një muaj. Gjykata vendimin e referon në nenin 9, 18 të Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, neni 136,159 të LMD-së.

Dhomat e shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, aprovon vlerësimin juridik të dhomës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga

ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 9 dhe 18 të Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, që parasheh:

9.Sigurimi nga autopërgjegjësia mbulon: 1.1. dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik.

18.Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësiesë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës respektivisht nga provat e administruara rezulton se me datë 01.04.2015 paditësi duke drejtuar automjetin e vet transportues me traga 631-KS-944, është goditur nga automjeti i udhëtarëve me tabela KM-010-CC, i cili nuk kishte policë të sigurimit dhe i pa regjistruar, të cilin e drejtonte V. R. Kolegji vlerësoi se në këtë rast palët ndërgjyqëse kanë arrit Ujdi jashtëgjyqësore datës 29.12.2015 me të cilën paditësi është kompensuar për dëmin material në automjet në shumën prej 6663.00€, ndërsa në rastin konkret nga provat e administruara në dhomën e shkallës së parë, vërtetohet se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur për shkak të pamundësisë së përdorimit të automjetit transportues 22 ditë pune, për nevojat e veprimtarisë së tij afariste në transportim të mallrave.

Nga kjo gjendje faktike që ka rezultuar sa i përket përgjegjësiesë së dëmit të shkaktuar ndaj paditësit, nga aksidenti i komunikacionit dt.01.04.2015, Kolegji vlerësoi se me te drejt dhoma e shkallës së parë, ka konstatuar se të paditurit i takon përgjegjësia për shpërblimin e dëmit ndaj paditësit si pasojë e shkakimit të dëmit në automjetin transportues, nga automjeti i pasiguar, sikurse parashihet me dispozitat ligjore të lartcekura.

Dhoma e shkallës së dytë nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet ankimore të paditurit se nuk është zbatuar drejt neni 160 par.4 të LPK-së, se paditësi nuk ka interes juridik për fillimin e kësaj procedure, për shkak të ujdës jashtëgjyqësore të nënshkruar, se gjykata i ka falur besimin provës fiktive, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me ndonjë shkelje që do të kishte ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike.

Dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmbanë arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e shkallës së dytë. Kolegji nuk i vlerësoi të bazuara pretendimet ankimore se paditësi ka heq dorë nga pasojat tjera me nënshkrimin e Ujdisë gjyqësore, sepse me këtë akt palët janë dakorduar vetëm për kompensimin e dëmit material në automjet (neni IV), që rezulton se nuk ka pajtim për kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur, i cili dëm është vërtetuar se i është shkaktuar paditësit për shkak të mos përdorimit të automjetit transportues, e që nga ekspertiza e makinerisë datës 20.01.2020 rezulton se koha e nevojshme e riparimit të automjetit është 22 ditë pune. Gjithashtu Kolegji vlerësoi se në këtë rast Dhoma e shkallës së parë ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit për pjesën e kompensimit të dëmit në emër të fitimit të humbur shumë prej 2,002.40€ për 22 ditë pune, pra nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurit se Dhoma e shkallës së parë i ka falur besimin provës fiktive sa i përket periudhës së qëndrimit të automjetit transportues të paditësit në servis për riparim nga data 02.04.2015 deri me 20.01.2016, ashtu që kjo pjesë e kërkesëpadisë së paditësit është refuzuar sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i dhomës së shkallës së parë, nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, se aktgjykimi përmbanë arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhomat e shkallës së dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.1322/24 datë 27.11.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari
Krenar Berisha